



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Tiranë, më 19.12.2016

Dokument parlamentar

R A P O R T
(për dhënie mendimi)
për projektligjin

“Për miratimin e kontratës ndryshuese të kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “SICPA Security Solutions, S.A.” e “SICPA Security Solutions, Albania” sh.p.k., “Për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, të miratuar me ligjin nr.10381, datë 24.2.2011”

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në mbledhjen e tij të datës 19 dhjetor 2016, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e kontratës ndryshuese të kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “SICPA Security Solutions, S.A.” e “SICPA Security Solutions, Albania” sh.p.k., “Për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, të miratuar me ligjin nr.10381, datë 24.2.2011”, nismë e Këshillit të Ministrave.

Të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve në lidhje me përmbajtjen e projektligjit ishin Zëvendësministri i Financave dhe specialistë të kësaj ministrie si dhe ministri i Shëndetësisë dhe specialistë të kësaj ministrie.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar nën 32- 39 të Rregullores së Kuvendit.

Gjatë diskutimit në parim deputetët shtruan një sërë pyetjesh në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, nëse ky projektligj bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi për koncesionet, nëse do të sjellë rritje të çmimit të barnave rritja e çmimit të pullës së barnave, periudha e ndryshimit të kontratës koncesionare, përballimi i rritjes së kostove, nëse do të ketë garanci për furnizimin me barna pa pengesa, a është bërë një studim për ecurinë e kontratës koncesionare dhe nëse është bërë një studim për vendosjen e çmimit të pullës së barnave, etj.

Përfaqësuesit e qeverisë u shprehën se qëllimi i propozimit të këtij projektligji është ndryshimi i kontratës së koncesionit (me anë të një kontrate ndryshuese) për ngritjen e një sistemi kombëtar për kontrollin dhe gjurmueshmërinë e barnave si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli antimashtrim të shpërndarjes së barnave në Republikën e Shqipërisë. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje synon të arrijë një sistem të plotë që jep siguri në qarkullimin e barnave në të gjithë territorin, nëpërmjet gjurmimit të barnave në të gjithë rrugën që ato ndjekin deri tek pacientët.

Me qëllim ngritjen e një sistemi kombëtar për kontrollin dhe gjurmueshmërinë e barnave (sa më aktual duke iu referuar faktit se kontrata koncesionare është dakordësuar mes palëve në vitin 2010), Ministria e Shëndetësisë ka paraqitur kërkesat e saj teknike në lidhje me funksionalitetin dhe objektivat që duhet të arrihen me ngritjen e një sistemi kontrolli antimashtrim të shpërndarjes së barnave në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i këtij dokumenti është të përshkruajë zgjidhjen teknike të propozuar për implementimin e sistemit dhe arritjen e objektivave. Ai bazohet dhe shtrihet tek platforma SICPATRACE® sipas marrëveshjes ndërmjet palëve dhe specifikisht në kontrollin e produkteve farmaceutike, ku përfshihen: jetëgjatësia e pullave; jetëgjatësia e barnave; tiparet e pullave specifike të dedikuara për produktet farmaceutike; mjetet dhe metodat e verifikimit dhe të autentifikimit; ndërfaqet me sistemet e tjera; konsideratat e vazhdimësisë së biznesit.

Zgjidhja ekzistuese teknike SICPATRACE® do të mbahet dhe do të zgjerohet për të ofruar sistemin e kontrollit antimashtrim të shpërndarjes së barnave në Republikën e Shqipërisë. Në veçanti, infrastruktura e Sistemit të Menaxhimit të të Dhënave SICPATRACE® do të rritet për të akomoduar kërkesat shtesë të përpunimit të të dhënave dhe kapacitetin e ruajtjes.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe AKBKPSH.

Deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste u shprehën pro miratimit në parim të këtij projektligji pasi miratimi i tij siguron duke i rekomanduar Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat që të shqyrtojë me vëmendje çmimin e pullës së barnave, duke vlerësuar mundësinë e vendosjes së saj mbi çmimin CIF të produktit farmaceutik.

Deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim u shprehën kundër miratimit në parim të këtij projektligji, pasi ndryshimet e propozuara të marrëveshjes nuk bazohen në një studim të mirëfilltë të institucioneve shtetërore në lidhje

me përcaktimin e çmimit të pullës së re të barnave. Barnat nuk mund të barazohen me produktet e tjera si duhani, alkooli, etj. Barnat janë produkte të domosdoshme për jetën e qytetarëve dhe nuk mund të konsiderohen si produkte shitja e të cilave do të rregullojë sistemin fiskal. Çmimi i vendosur i pullës së barnave, si një përqindje mbi çmimin e shitjes me pakicë të çdo produkti farmaceutik është tepër i lartë dhe ky çmim do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e çmimit të barnave dhe e gjithë kjo do të rëndojë mbi pacientët. Kjo marrëveshje duhet të rinegociohet.

Deputetët e opozitës në komision votuan kundër projektligjin në parim, me argumentin se ky ndryshim i marrëveshjes ka shumë paqartësi në mënyrën sesi është hartuar propozimi, mbi cilin studim janë bazuar nismëtarët për ndryshimin e marrëveshjes, kostot e këtij ndryshimi i kalojnë tërësisht pacientëve. Ky projektligj duhet risihikuar, pasi jo vetëm bie në kundërshtim me ligjin për koncesionet, por bie ndesh edhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi koncesionari, i cili është një subjekt privat do të përpunojë të dhënat personale të pacientëve, inventarët e subjekteve farmaceutike, etj., të cilat janë kompetencë e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Ndryshimi i marrëveshjes koncesionare i propozuar me këtë projektligj, do të rrisë çmimin e barnave për pacientët, duke shtuar më tej kostot që ata duhet të paguajnë për të përfutur shërbimin shëndetësor, i cili në fakt u ishte premtuar falas. Nga kjo marrëveshje humbet sistemi i gjurmimit *track and trace* të barnave dhe sistemi i pullave dyfishe të barnave, i cili i lejonte FDSKSH për gjurmimin e recetave fallso.

Komisioni rrëzoi projektligjin me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

KRYETARE
Albana VOKSHI